



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

**RAPORT**  
*(Pwrfundimtar)*

**PËR**  
**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT**  
**CIVIL**

**AVOKATI I POPULLIT**

**TIRANË**

**Tiranë, Korrik 2023**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Avokati i Popullit, Tiranë.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes, si dhe të Vendimit nr. 141, datë 22.12.2022 “*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira, si dhe në lidhje me procedurën disiplinore në shërbimin civil, në institucionin Avokati i Popullit*”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në institucionin Avokati i Popullit, Tiranë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, është institucion kushtetues i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Avokatit të Popullit.

Në nenin 2 të këtij ligji, është përcaktuar se, *Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe intereset e ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe të lirive të njeriut në vend.*

*Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë.*

Pranë Avokatit të Popullit, vepron administrata, e cila realizon të gjithë veprimtarinë e nevojshme administrative.

Në ligjin organik është përcaktuar se struktura dhe organika e institucionit, caktohen nga Avokati i Popullit dhe personeli bën pjesë në shërbimin civil.

Kjo do të thotë që, për të gjithë punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, zbatohet ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke filluar që nga momenti i rekrutimit, pra, pranimi në shërbimin civil dhe duke vazhduar me të gjitha procedurat që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

Evidentojmë faktin se, edhe para fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për punonjësit e Avokatit të Popullit, janë rregulluar me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, i zbatueshëm për atë kohë, tashmë i shfuqizuar.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2 dhe 39 të ligjit “*Për Avokatin e Popullit*”, është hartuar dhe funksionon edhe Rregullorja e Brendshme “*Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit*”, miratuar me Urdhërin nr. 129, datë 17.06.2022 të Avokatit të Popullit. Kjo Rregullore është në koherencë me ndryshimet e strukturës së institucionit dhe ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të institucionit, të drejtat dhe detyrimet për të gjithë punonjësit, administrimin e dokumentacionit të krijuar, të mbledhur apo të ardhur në adresë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, në këtë akt është përcaktuar se Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil dhe drejtuesi më i lartë administrativ në këtë institucion dhe ka përgjegjësi menaxheriale të “*Nëpunësit të autorizuar*”, sipas përcaktimeve të nenit 9, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar.

Nga sa më sipër, duke qenë se ky institucion përfshihet në skemën e shërbimit civil, atëherë ai është subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 16.01.2023, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 789/1 prot., datë 22.12.2022, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 789/2 prot., datë 22.12.2022, “*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Avokati i Popullit*”.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe zhvillimi i procedurës disiplinore, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike të administrimit në këto procese.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Valentina Kolleshi, Zamira Mujali dhe Dorela Halilaj, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Avokati i Popullit.

Ky material, me shkresën nr. 623/1 prot., datë 31.5.2023, u dërgua për njohje, pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 331/1 prot., datë 15.6.2023, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

### **Drejtimet e mbikëqyrjes**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
  - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
  - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.

4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25 të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26 i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
  - verifikimit paraprak;
  - vlerësimi i kandidatëve.
8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore:
  - konstatimi i shkeljes disiplinore;
  - kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore;
  - ngritja e Komisionit të Disiplinës dhe hapat procedural që ndjek ky organ deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar.
10. Vlerësimi i rezultateve në punë, si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues, zyrtar autorizues*).
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore/njësisë përgjegjëse, gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces.

1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
2. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit që ka qenë në fuqi në Janar 2020.
3. Listëprezenca dhe listëpagesa e nëpunësve të institucionit në muajin Janar 2020.
4. Listëprezenca dhe listëpagesa e nëpunësve të institucionit në muajin Dhjetor 2022.
5. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është përfshirë në procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet pranimit nga jashtë në nivelin ekzekutiv, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë.
6. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
  - Plani vjetor i rekrutimit ku të jetë përfshirë edhe nevoja për rekrutim nga jashtë shërbimit civil për pozicionet e ulta dhe të mesme drejtuese (20%) dhe të lartë drejtuese (15%).
  - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë -nivel i lartë drejtues/nivel i ulët ose i mesëm drejtues*).
  - Kërkesa dërguar SHKP/shpallja në faqen e internetit të institucionit.
  - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*).
  - Aktet që materializojnë përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Pranimit - për nivelin ekzekutiv.
  - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak:
    - Lëvizje paralele nivel ekzekutiv (*dërgimi për publikim në SHKP*);
    - Lëvizje paralele në nivelin e mesëm dhe të ulët (*dërgimi për publikim në SHKP*);
    - Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
    - Ankimimi;
  - Aktet që materializojnë procesin e pranimit në shërbimin civil:

- verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*) në nivel ekzekutiv;
  - procesverbli i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPP /sekretimi;
  - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim; pyetjet e përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
  - pyetjet e intervistes me gojë;
  - deklarata e rregjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPP;
  - raporti i KPP për rezultatet (*para ankesave*);
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
  - shpallja e fituesit në SHKP;
  - deklarata e pranimi të pozicionit – rregjistrimi në listën e fituesve të atyre që nuk pranojnë pozicionin;
  - procedura e ankimimit nëse ka;
- Aktet që materializojnë procesin e ngritjes në detyrë:
    - akti që materializon ngritjen e Komitetit të Pranimi;
    - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);
    - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
    - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
    - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
    - pyetjet e intervistës me gojë;
    - deklarata e rregjistrimit audio;
    - deklarata e paanësisë së KPND;
    - raporti i KPND;
    - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
    - shpallja e fituesit në SHKP;
    - akti që materializon vendimin për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 26/4 (*për 20%*) dhe për pranim në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues (*për 15 %*);
    - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar pas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);
    - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
    - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
    - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim sipas pyetjeve të përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;

- procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - pyetjet e intervistës me gojë;
  - deklarata e regjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPND;
  - raporti i KPND;
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues
  - shpallja e fituesit në SHKP;
  - akti i emërimit të punonjësve në pozicionin e shërbimit civil
7. Materialet që dokumentojnë zhvillimin e procedurës disiplinore.
- kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore;
  - ngritja e Komisionit të Disiplinës;
  - njoftimi me shkrim I nëpunësit për fillimin e ecurisë disiplinore;
  - shkakun e nisjes, si dhe të drejtat e nëpunësit për sqarimin e shkeljes;
  - vendimi i Komisionit të Disiplinës i arsyetuar në shpjegimin e fakteve.
8. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.
9. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit, \*\*\*\*\* dhe me Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, \*\*\*\*\* , gjatë të cilit u diskutua mbi qëllimin, programin dhe drejtimit të mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, të miratuar për institucionin e Avokatit të Popullit.



- U verifikuan procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për periudhën janar 2020 - maj 2022; dokumentet e administruara në dosjen e personelit që provojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat individuale të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave specifike të pozicionit të punës si, niveli i diplomës së studimeve universitare, fusha kryesore e studimeve dhe përvoja në punë e lidhur me e arsimin e lartë që ka çdo nëpunës civil.
- U verifikua ligjshmëria e akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil, për të gjithë ata nëpunës që e kanë përfituar këtë status sipas parashikimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete të cilat janë pjesë e këtij raporti (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*).

### **Përmbajtja e Raportit:**

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.**

#### **I/1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.**

Institucioni i Avokatit të Popullit, është institucion kushtetues i pavarur, që drejtohet nga Avokati i Popullit, i cili zgjidhet nga Kuvendi. Organizimi i brendshëm i institucionit bazohet në strukturën dhe organikën, që sipas nenin 35, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, caktohen nga Avokati i Popullit në përputhje me numrin e punonjësve të miratuar në buxhetin vjetor të institucionit.

Nisur nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në Janar 2020, institucioni ishte i organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhërin nr. 252/40 prot., datë 5.4.2019, të Avokatit të Popullit, “Për disa ndryshime në strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës, të institucionit të Avokatit të Popullit”. Bazuar në këtë strukturë organizative,

rezulton se, ky institucion, në këtë periudhë, ka patur gjithsej 56 pozicione pune, nga të cilat, 36 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Më pas, për nevoja pune të institucionit, në buxhetin e vitit 2022, u shtua 1 (një) punonjës, me emërtesën “Ndihmëskomisioner”, duke çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve në 57, nga të cilat 37 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil. Kjo shtesë, si dhe disa ndryshime në organizimin dhe funksionimin e institucionit u reflektuan në strukturën organizative të institucionit të miratuar me Urdhërin nr. 17, datë 4.2.2022, të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, duke parë strukturën dhe organikën e re të institucionit, konstatohen ndryshime edhe në mënyrën e organizimit të “Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve”. Kjo drejtori më parë ka qenë e organizuar në 3 sektorë, ndërsa në strukturën aktuale drejtorja si më sipër, është e organizuar në 4 sektorë, duke ruajtur të njëjtin numër pozicionesh në shërbimin civil. Ndryshimi në këtë rast, konsiston në ndarjen e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në dy sektorë që janë: 1) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe 2) Sektori i Shërbimeve.

Më tej nga analiza e mënyrës së organizimit në këtë rast, konstatohet se vërtet nuk ka ndryshim në numër të punonjësve, por ka një rishpërndarje të burimeve njerëzore dhe një ndryshim në klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil. Rezulton që 1 pozicion i nivelit ekzekutiv është shkurtuar dhe është krijuar 1 pozicion i ri i nivelit të ulët drejtues, duke sjellë edhe ndryshime të kritereve të pozicioneve të punës, tipare këto të një procesi riorganizimi dhe ristrukturimi të Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të punës, rezulton se institucioni nuk i ka konsideruar si proces ristrukturimi ndryshimet e ndodhura në strukturën e miratuar dhe për pasojë, nuk ka ndërmarë asnjë hap për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në këtë rast.

Në këtë moment, institucioni duhet të ngrëjë Komisionin e Ristrukturimit, i cili punën e vet duhet ta bazojë në këto drejtime:

Së pari, të krahasojë strukturën e re me strukturën ekzistuese dhe të evidentojë njësitë e reja organizative që krijohen, suprimohen apo që ndryshojnë, si dhe pozicionet që preken nga ristrukturimi, ato që krijohen dhe ato që suprimohen.

Së dyti, të verifikojë përshkrimet e punës për pozicionet e krijuara, të mbetura apo të ristrukturuara.

**Së treti**, të verifikojë dosjet personale të nëpunësve civilë, për të evidentuar përvojën në punë, arsimin dhe vlerësimin e arritjeve në punë.

Gjithashtu, të verifikojë nëse ka nëpunës me probleme shëndetësore të vërtetuar me raport mjekësor, si dhe largësinë e vendbanimit me vendin e punës (më shumë se 45 km).

**Së katërti**, pas krahasimit dhe vlerësimit të informacionit të mbledhur për nëpunësit civilë me informacionin për pozicionet e punës, bën propozimin njësisë përgjegjëse për emërimet e nëpunësve në pozicionet e krijuara sipas strukturës.

Në këtë rast, jemi përpara faktit që njësia përgjegjëse e institucionit, nuk ka zbatuar asnjë nga detyrimet ligjore të sipërpërmendura, por në përfundim të procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve të reja të krijuara apo të mbetura të lira, ka nxjerrë aktin e emërimit rast pas rasti.

Aktualisht, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, institucioni është i organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhërin nr. 17/1, datë 24.05.2022, *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”*.

Sipas kësaj strukture, institucioni ka gjithsej **57** pozicione pune, nga të cilat 4 (katër) pozicione pune janë të lira, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **6** pozicione pune janë **funksionarë të lartë shtetëror të zgjedhur nga Kuvendi** (1 Avokati i Popullit; 5 Komisionerë);
- ✓ **5** pozicione pune funksionarë politikë të përfshirë në **kabinetin e Avokatit të Popullit** (1 Drejtor Kabineti, 3 Këshilltarë; 1 Sekretare)
- ✓ **39** pozicione pune janë **pjesë e shërbimit civil**;
- ✓ **7** pozicione pune janë **punonjës administrativë** (1 punonjëse arkivist/bibliotekar; 1 punonjës teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme; 3 drejtues automjeti; 2 punonjëse pastrimi).

Nga sa më sipër, struktura dhe organika, në përmbajtjen e saj, ka të evidentuar në mënyrë të qartë pozicionet e punës të kategorizuara sipas ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar:

- ✓ për funksionarët e lartë të institucionit dhe funksione politike;
- ✓ pozicionet e punës ndaj të cilëve zbatohet ligji për nëpunësin civil;
- ✓ pozicionet e punës që kryejnë funksione administrative.

Nga përmbajtja e strukturës, konstatohet se, organizimi i saj, përmbush standartet e vendosura për funksionimin e saj sipas ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përcaktohen kriteret dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore.

Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, është bërë mbi bazën e përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ku, për çdo pozicion pune, është mbajtur parasysh natyra e pozicionit sipas specifikave të tij, si dhe përshkrimi i punës.

Në rastin konkret, **39 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në institucionin e Avokatit të Popullit**, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë në nivelin e lartë drejtues, janë 14 pozicion pune, ose rreth 35 % e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve:

*“1 pozicion - Sekretar i Përgjithshëm, kategori page I-a”,*

*“13 pozicione – Ndihmëskomisioner, kategori page II-a”.*

- Nëpunës civilë në nivelin e mesëm drejtues, janë 10 pozicione pune, ose rreth 26% e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicioneve,

*“1 pozicion - Drejtor Drejtorie, kategori page II-b”,*

*“9 pozicione – Ndihmëskomisioner, kategori page II-b”.*

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë 5 pozicione pune, ose rreth 13 % e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit, “Përgjegjës sektori, kategori page III-a”:

- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë 10 pozicione pune, ose 26 % e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit, “Specialist, kategori page III-b”.

Evidentojmë faktin se, Sektori i Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, paraqitet si njësi përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil të institucionit në fjalë.

Më tej, konstatohet se, struktura organizative për pozicione të punës pjesë e shërbimit civil dhe niveli i pagave, është në përputhje edhe me përcaktimet e Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve..., disa institucione të pavarura....*”, të ndryshuar, ku përfshirja e Avokatit të Popullit në fushën e veprimit të këtij vendimi është parashikuar në pikën 1, paragrafi 1/1, të tij.

Konstatohet se, institucioni funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme, e cila, siç e theksuam edhe më lart në material është e përditësuar dhe miratuar me Urdhërin nr. 129, datë 17.06.2022, të Avokatit të Popullit, e përditësuar kjo pas miratimit të strukturës aktuale të institucionit në të cilën, janë përcaktuar rregullat procedurale për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të administratës, si dhe janë evidentuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë çdo Seksion dhe Drejtori, në përputhje me rolin dhe misionin e këtij institucioni.

Gjithshtu, në këtë rregullore, janë pasqyruar parimet dhe rregullat që sanksionon ligji nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, të cilat materializohen edhe në përshkrimin e punës, në përputhje me ligjin për shërbimin civil.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, nga analiza e përmbajtjes së strukturës, vlerësohet se, institucioni i mbikëqyruar, është i organizuar mbështetur në strukturën organizative hierarkike dhe në përmbajtjen e saj prezantohet statusi i punësimit të punonjësve, i ndarë në tre nivele *a) funksionarë shtetërorë dhe politikë, b) nëpunës civilë dhe c) punonjës administrativë*, si dhe është përcaktuar klasifikimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kategoria e tyre e pagës.

Numri i punonjësve për çdo njësi organizative (seksione + drejtori + sektorë), është brenda kufirit të miratuar.

Por nga ana tjetër, duke bërë krahasimin e strukturës dhe organikës së vitit 2020, me strukturën dhe organikën e vitit 2022, me ndryshimet që kanë ndodhur, janë përmbushur arsyet që çojnë në një proces ristrukturimi, procedurë kjo e pakryer nga njësia përgjegjëse e këtij institucioni.

Për këtë arsye, në vijimësi, njësia përgjegjëse e institucionit, në rastet kur, ndryshimet strukturore sjellin ndryshime në organizimin dhe funksionimin e institucionit, duhet të veprojë sipas përcaktimeve të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin*

*dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.*

- II. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.**

***II/1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.***

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Këto dispozita përcaktojnë se, institucionet e pavarura, në përgatitjen e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të kenë parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera.

Më tej, në pikat 11 dhe 13, të aktit nënligjor si më sipër, përcaktohet se institucionet e pavarura, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miratojnë planet e veta të pranimit në pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe publikimi në portalin: “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të institucionit dhe në stendat për njoftime publike të institucionit, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrencës.

Nga dokumentacioni i këqyrur për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në lidhje me miratimin e këtij plani, rezulton si më poshtë:

➤ *Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2020*

Me aktin nr. 42/11, datë 13.05.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për miratimin e Planit Vjetor të pranimeve në shërbimin civil në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2020”,

është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e pozicioneve të lira për vitin 2020, të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni, “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre.
- Pozicioni, “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës.
- Pozicioni, “*Përgjegjës sektori*”, në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Vihet re se në këtë plan nuk është saktësuar numri i pozicioneve të lira dhe kategoria e pagës, për pozicionin, “*Ndihmëskomisioner*”.

➤ *Plani i Pranimi në Shërbimin Civil, viti 2021*

Me aktin nr. 3, datë 05.01.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Për miratimin e Plani Vjetor të pranimeve në shërbimin civil në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2021*”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e pozicioneve të lira për vitin 2021, të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni, “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, kategoria II-a.
- Pozicioni, “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, kategoria II-b.
- Pozicioni, “*Përgjegjës sektori*”, në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.
- Pozicioni, “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve, kategoria III-b.

Në vijim me aktin nr. 3/1, datë 6.1.2021, të Avokatit të Popullit, “*Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2021*”, është përcaktuar që pozicioni “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, të jetë i hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës, në përqindjen përkatëse sipas nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

➤ Plani i Pranimiit në Shërbimin Civil, viti 2022.

Me aktin nr. 21, datë 11.02.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për miratimin e Plani Vjetor të pranimeve në shërbimin civil në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2022”, është miratuar plani i rekrutimit për plotësimin e pozicioneve të lira për vitin 2022, të paraqitura si më poshtë:

- Pozicioni, “Ndhmëskomisioner”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, kategoria II-a.
- Pozicioni, “Ndhmëskomisioner”, në Seksionin e Organeve të Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, kategoria II-b.
- Pozicioni, “Ndhmëskomisioner”, në Seksionin e Përgjithshëm, kategoria II-a.
- Pozicioni, “Përgjegjës sektori”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.
- Pozicioni, “Specialist protokollit”, në Sektorin e Shërbimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Konstatohet se pas miratimit të planit të rekrutimit për vitin 2022, Avokati i Popullit me aktin nr. 35, datë 24.02.2022, “Për hapjen e procedurës së pranimiit në kategorinë e lartë drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2022”, si dhe me aktin nr. 102, datë 24.05.2022, “Për hapjen e procedurës së pranimiit në kategorinë e mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2022”, ka përcaktuar që pozicioni “Ndhmëskomisioner kategori page II-a”, si dhe “Ndhmëskomisioner kategori page II-b”, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës, në përqindjen përkatëse sipas nenit 32, pika 1 dhe nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Konstatohet se pozicioni i punës “Ndhmëskomisioner, kategori page II-b”, në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar, i shpallur i lirë dhe i planifikuar për tu plotësuar me kandidatë nga jashtë shërbimit civil (20%), nuk është përfshirë në planin e rekrutimit për vitin 2022.

**Konkluzion:** Në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimiit në shërbimin civil, për periudhën 2020 – 2022, sjellim në vëmendje të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, se në vijim, në rastet e lindjes së nevojës së zhvillimit të procedurave të konkurrimit për pozicione të krijuara të lira pas miratimit të planit vjetor të rekrutimit, si rrjedhojë e dorëheqjes, pezullimit (për një afat më të gjatë se 3 muaj), apo lirit nga shërbimi civil, sipas shkaqeve të parashikuara në ligj, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masa për



reflektimin e vakancës nëpërmjet ndryshimit të planit vjetor sipas kërkesave të akteve përkatëse nënligjore.

## ***II/2. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv nëpërmjet konkurrimit.***

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25); Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Dispozitat ligjore si më sipër, përcaktojnë rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, për plotësimin e vendeve të lira në këtë rast, fillimisht organizohet procedura e lëvizjes paralele, e më pas, nëse mbeten pozicione të lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, rezulton se, nga **9** pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive “*Specialist*”, të cilat janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit të hapur, **2** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, ndërsa, **7** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, ku **1** rast është përmbyllur me rekrutim të kandidatit fitues të marrë nga lista e fituesve brenda kohës së vlefshmërisë së saj.

Në rastin konkret, janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele pozicioni i kategorisë ekzekutive, “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, si dhe pozicioni, “*Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European.

Nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, janë plotësuar **7** pozicione pune si më poshtë:

- Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit, (4 pozicione)
- Specialist i prokurimeve, (2 pozicione)
- Specialist protokolli, (1 pozicion)

Grupi i punës, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit, proces i cili përfshin:

- a) Shpalljen e konkurrimit për vendin e lirë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të institucionit;
- b) Verifikimin paraprak nga njëسيا përgjegjëse, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit;
- c) Vlerësimin e kandidatëve nga komiteti i përhershëm i pranimit dhe komiteti për ngritjen në detyrë i cili përfshin vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, një testim me shkrim dhe një testim me gojë;
- d) Shpalljen e listës së fituesve, administrimin e kësaj liste nga njëسيا përgjegjëse dhe nxjerrjen e aktit të emërimit në shërbimin civil për kandidatët fitues.

Nga verifikimi i akteve, të cilat materializojnë konkurrimet e shpallura nga institucioni Avokati i Popullit, për plotësimin e vendeve të lira të kategorisë ekzekutive, konstatohet se, është vepruar si më poshtë:

- ✓ Legjislacioni i shërbimit civil parashikon se shpallja e konkurrimit për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, sipas pikës 6, Kreu II, të Vendimit nr.243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, për institucionet e pavarura, bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut, si dhe në faqen e internetit.

Gjatë mbikëqyrjes, rezulton se, ky detyrim ligjor, nga ana e institucionit, **për procedurat e shpallura për periudhën objekt mbikëqyrjeje (vitet 2020 – 2022), është përmbushur.**

Konkretisht janë shpallur pozicionet e punës si më poshtë:

- Specialist i prokurimeve, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve (3 procedura shpallur në dt. 16.12.2019; shpallur në dt.25.2.2021; shpallur në dt. 9.11.2022);
- Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit, në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve (4 procedura, shpallur në dt. 5.2.2020; shpallur në dt. 22.4.2020; shpallur në dt.17.8.2020; shpallur në dt. 6.6.2022);
- Specialist në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European (shpallur në dt. 24.8.2021);
- Specialist protokolli, në Sektorin e Burimeve Njerëzore (shpallur në dt. 2.3.2022);
- ✓ Në aktin nënligjor që rregullon fazën e shpalljes së vendit të lirë, është përcaktuar se, “aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranim në

*shërbimin civil), duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike”.*

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me rregullimet e pikës 1 dhe 2, të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet se, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet *së pari*, nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka një fitues, atëhere njësia përgjegjëse organizon procedurën e pranimit në shërbimin civil nëpërmjet konkurrimit të hapur.

Në rastin konkret në institucionin e mbikëqyrur konstatohet se, nga 9 procedurat e konkurrimit të kryera, në 2 raste, procedurat janë finalizuar me lëvizje paralele me nëpunës civilë të së njëjtës kategori nga brenda institucionit, si dhe nga institucion tjetër; në 1 rast pozicioni i punës është plotësuar me kandidatin që ishte në listën e fituesve, brenda afatit të vlefshmërisë së saj; ndërsa në 6 raste, ka vazhduar procesi i rekrutimit pranimit me shërbimin civil.

- ✓ Legjislacioni kërkon që shpalljet e vendeve të lira të publikuara, të kenë të *përfshirë në pëmbajtjen e tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015*, si dhe kategorinë e pagës të pozicionit për të cilin është organizuar konkurrimi.

Në këtë rast, vërejmë se, megjithëse nga ana e institucionit janë zbatuar kërkesat e pikës 9, shpallja e procedurës së konkurrimit, nuk është bërë *për grup pozicionesh*, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta.

Në lidhje me këtë konstatim, mund të përmendim faktin se, procedurat e konkurrimit janë kryer më vete për pozicionet me emërtesën “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, pavarësisht se kërkesat kanë qenë të njëjta si për nivelin arsimor ashtu edhe për kërkesat e tjera të veçanta.

- ✓ Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezultoi se, janë respektuar afatet e parashikuara në pikën 8 e 10, të Kreut II, të VKM nr. 243, d. 18.3.2015, i ndryshuar, pika 9, Kreu II, e VKM nr.242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranimit në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

## *II.2/a. Procedura e lëvizjes paralele.*

Plotësimi i vendeve të lira të kategorisë ekzekutive nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, në këtë institucion, është bërë për 2 raste, për pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian dhe për pozicionin, “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve. Në të dyja procedurat ka patur nga 1 kandidat, nëpunës civilë të së njëjtës kategori (*një kandidaturë kryente detyra brenda institucionit dhe kandidatura tjetër në institucion tjetër*), që plotësonin kushtet për lëvizjen paralele, si dhe kërkesat e posaçme të vendit të punës, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 25, të ligjit.

Të dy pozicionet janë shpallur në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe në faqen e internetit të Avokatit të Popullit, përkatësisht:

- “*Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian, shpallur në datën 24.8.2021;
- “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, shpallur në datën 9.11.2022.

Në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, për të dyja procedurat, janë të përfshira të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 4, të kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës;
- e) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) data e daljes së rezultateve të konkurimit;
- gj) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Procedura e lëvizjes paralele, sipas pikës 6, Kreu VII, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, përfshin dy faza:

- a) Verifikimin e kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- b) Vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, në zbatim të pikave 7, 8, 9 e 10, të Kreut VII, të aktit nënligjor, njësia përgjegjëse, ka vepruar si më poshtë:

- Ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim,
- Ka bërë njoftimin e verifikimit paraprak (*lista me emrat e kandidatëve*), publikuar në SHKP dhe në faqen e internetit të institucionit,
- Në fazën e verifikimit paraprak nuk kishte kandidatë të s’kualifikuar.

➤ Vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Brendshëm.

Në bazë të përcaktimeve të pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave nga 12 deri në 18/1, të Kreut VII, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm, i cili bazohet në strukturën e ndarjes së pikëve si më poshtë:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë, për përvojën (*10 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave; 15 pikë për tejkallim të kërkesave; 20 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave*), 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (*3 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave; 5 pikë për tejkallim të kërkesave; 10 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave*), 10 pikë për certifikimin/vlerësimet më të fundit pozitive (*5 pikë për certifikimin/vlerësimin “mirë”; 10 pikë për certifikimin/vlerësimin në nivelin “shumë mirë”*).
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Komisioni i Brendshëm, sipas akteve ligjore, ka në përbërje të tij 3 anëtarë:

- a) 1 përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njejtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet;
- b) eprorin direkt;
- c) 1 përfaqësues të emëruar nga titullari i institucionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në të dyja rastet është ngritur Komisioni i Brendshëm, për procedurën e vitit 2021, me Urdhërin nr. 119, datë 9.9.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm dhe për procedurën e vitit 2022, me Urdhërin nr. 222, datë 30.11.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Komisioni i Brendshëm ka vepruar në këtë mënyrë, në lidhje me vlerësimin e kandidatëve:

- ✓ Janë njoftuar kandidatët nëse janë dakord që intervista të regjistrohet; në deklaratat e nënshkruar prej tyre, kandidatët pjesëmarrës nuk kanë pranuar që intervista të regjistrohet.
- ✓ Në përfundim të procedurave të konkurrimit, Komisioni i Brendshëm respektiv, ka bërë vlerësimin përfundimtar për dokumentacionin e dorëzuar dhe intervistën me gojë, duke vlerësuar kandidatët për secilën procedurë, përkatësisht: \*\*\*\*\* 74 pikë dhe \*\*\*\*\* 83 pikë.

Në përfundim të secilës procedurë, në datat 14.9.2021 dhe 5.12.2022, është bërë publikimi për shpalljen e fituesit, në portalin SHKP dhe në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit. Më pas njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit për secilin fitues si më poshtë:

\*\*\*\*\*, me aktin nr. 121, datë 15.9.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European;

\*\*\*\*\*, me aktin nr. 222/1, datë 9.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin, “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve.

**Konkluzion:** Nga gjithë sa sipër, Komisioneri vëren se, gjatë zhvillimit të procedurës së *lëvizjes paralele*, për pozicionin, *Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European, në vitin 2021, si dhe për pozicionin, “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, në vitin 2022, njësia përgjegjëse është kujdesur që të zbatohen kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

## ***II.2/b. Procedura për pranimin në shërbimin civil***

Në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të ngelura të lira pas aplikimit të lëvizjes paralele, grupi i punës verifikoi dokumentacionin e procedurave të konkurrimit për pranimin në kategorinë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton që nga njësia përgjegjëse e institucionit të Avokatit të Popullit, për periudhën Janar 2020 - Dhjetor 2022, janë realizuar 7 procedura konkurrimi për pranim në shërbimin civil.

Gjatë zhvillimit të këtyre procedurave, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- ✓ Në të gjitha rastet, ka bërë shpalljen e procedurës së pranimit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në *Faqen Zyrtare*, të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit në shërbimin civil (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim.
- ✓ Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar është shpallur në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si dhe në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit.  
  
Sipas akteve të verifikuara, në të gjitha procedurat e zhvilluara, nuk ka patur kandidatë të s’kualifikuar në fazën e verifikimit paraprak dhe në këto kushte, nuk ka akte të verifikimit përfundimtar në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga kandidatët.
- ✓ Për 2 pozicione të shpallura, rezulton se, ka patur kandidatë për zhvillimin e procedurës me lëvizje paralele, por ka përfunduar pa asnjë të përzgjedhur. Njësia përgjegjëse, nëpërmjet e-mailit, ka njoftuar individualisht konkurrentin për rezultatin e procedurës për lëvizjen paralele.
- ✓ Njësia përgjegjëse, ka bërë njoftimin në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si dhe në faqen zyrtare të institucionit, për përfundimin e lëvizjes paralele pa fitues/pa kandidatë të interesuar dhe vazhdimin e procedurës së pranimit në shërbimin civil.

➤ Krijimi i Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP) dhe vlerësimi i kandidatëve

Nisur nga përcaktimi i pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullave të përcaktuara në Kreun III dhe IV (pikat nga 7 deri në 13), të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP).

Krijimi i KPP, përbërja e tij, si dhe detyrat që duhet të kryejë ky organ, janë të parashikuara në Kreun III dhe IV të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe ndarjen III/3, III/4, III/5, III/6, III/7 e III/8, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, sipas pikës 3, Kreu III, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson KPP-në;
- b) 2 anëtarë të zgjedhur nga titullari midis nëpunësve të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton që, institucioni i mbikëqyrur, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm ka ngritur KPP-në me 5 anëtarë. Në të gjitha rastet ky organ ka në përbërjen e vet, 3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm të fushës së vlerësimit të pozicionit që zhvillohet procedura konkurruese.

Sipas akteve ligjore të cituara më sipër, përfaqësuesi i burimeve njerëzore, duhet të jetë kryesuesi i KPP, por nga dokumentacioni i verifikuar, rezulton që Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, në të gjitha rastet është në cilësinë e anëtarit.

Gjithashtu, rezulton që Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur si më sipër, nuk ka funksionuar për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit, por ndryshe nga sa parashikon legjislacioni, ai është ngritur rast pas rasti për sejcilën procedurë të realizuar brenda të njëjtit vit.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje të institucionit që në vijim, njësia përgjegjëse, duhet të marrë masat për zbatimin e ligjit në ngritjen dhe kohëzgjatjen e këtij organi. Gjatë vitit të funksionimit të tij, mund të ndryshojë përbërja vetëm në rastet kur paraqitet nevoja e



ndryshimit të ekspertëve të fushës që do të kryhet testimi, ose në rast se ndonjeri prej anëtarëve paraqet pengesa ligjore.

Më tej, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, dispozitat ligjore kanë përcaktuar që totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- Deri në 15 pikë, për vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve (CV) që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive të përfshira në shpalljen për konkurrim;
- Deri në 60 pikë, për vlerësimin me shkrim (një testim i shkruar);
- Deri në 25 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati nuk konsiderohet fitues nëse nuk ka marrë mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve). Gjithashtu, në dispozitat ligjore si më sipër, parashikohet se, në intervistën e strukturuar me gojë, kanë të drejtë të marrin pjesë kandidatët, të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë).

Në lidhje me vlerësimin e kandidatëve nga KPP-ja, nga verifikimi rezulton se, **për vitet 2020 - 2022, janë ndjekur rregullat që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, në lidhje me këtë fazë të konkurrimit**, e konkretisht është vepruar në këtë mënyrë:

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPP, kanë hartuar testet përkatëse, të cilat, janë paraprirë nga procesverbali për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPP dhe është nënshkruar në fund prej tyre. Në të gjitha rastet mungon çelësi i përgjigjeve që duhet ta administrojë secili prej anëtarëve në momentin e zhvillimit të konkurrimit.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim sipas rregullave të përcaktuara në pikën 2, të ndarjes III/5, të udhëzimit të DAP, brenda fushës së njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim, por mungon bashkëlidhur përgjigja e saktë për secilën pyetje.

Anëtarët e KPP kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPP, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (në bazë të numrit të vlerësuesve).

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të vlerësimit të jetëshkrimit (i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr. 4, bashkëlidhur udhëzimit të DAP), kanë rradhitur

kandidaturat, të cilët kanë grumbulluar më shumë se 45 pikë (në rastet kur ka patur më shumë se 1 kandidat).

Në lidhje me *intervistën me gojë*, KPP ka vepruar në këtë mënyrë:

- ✓ Ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.
- ✓ Brenda afateve të parashikuara, KPP, ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar një procesverbal duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (numri i vlerësuesve).
- ✓ Në të gjitha rastet, kandidatët konkurrentë kanë nënshkruar deklaratat e pranimit ose mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.
- ✓ Në të gjitha rastet konstatohet se, ***mungon deklarata e paanësisë***, të cilën duhet ta nënëshkruajnë anëtarët e KPP, në fillim të procedurës së konkurrimit, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPP ka listuar kandidatët fitues me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve), por mungon një raport informues për rekrutimin dërguar njësisë së burimeve njerëzore. Lista e fituesve është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Konstatohet se, në procedurat e zhvilluara, nuk ka patur kandidatë të cilët kanë marrë më pak se 70 pikë (70% të pikëve). Në këto kushte, njësia përgjegjëse, pas mbarimit të afatit 5 ditor të ankimit nga kandidatët për rezultatin e vlerësimit (pika 22, *Kreu IV, e VKM nr.243, datë 18.3.2015*) në rastet kur ka patur më shumë se 1 kandidat konkurrent, ka bërë shpalljen e fituesit dhe procesi ka vijuar me daljen e aktit të emërimit.

Në vijim të analizës së procedurave të konkurrimit, rezulton se, njësia përgjegjëse e institucionit, ***për të gjitha pozicionet e nivelit ekzekutiv ka zhvilluar konkurrime individuale, si dhe numri i kandidatëve që kanë aplikuar në shumicën e konkurrimeve ka qenë 1 (një).***

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, vërehet se nga njësia përgjegjëse, janë bërë përpjekje që procedurat e rekrutimit, nëpërmjet konkurrimit të hapur për pozicionet e kategorisë ekzekutive, të kryhen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Por, pavarësisht aritjeve gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit në zbatim të planit vjetor të rekrutimit, për vitet respektive është konstatuar se:

Organizimi i procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, janë realizuar si procedura individuale, duke mos e vlerësuar më parë mundësinë e rekrutimit në grup pozicionesh. Duhet që në të ardhmen, aty ku paraqitet mundësia, procedurat konkurruese të realizohen sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë.

Përsa i përket ngritjes së Komitetit të Përhershëm të Pranimit, si dhe përbërjes së tij, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, në të ardhmen, gjatë ngritjes së këtij organi, duhet të zbatohen rregullat që përcaktojnë pikat 2 dhe 3, të Kreut III, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, sipas të cilave, pranë institucioneve të pavarura krijohet një Komitet i Përhershëm i Pranimit dhe njësi përgjegjëse (*njësia e burimeve njerëzore*) e institucionit është kryesuese e tij.

Në lidhje me procedurat e konkurrimit të zhvilluara gjatë viteve 2020-2022, janë evidentuar mangësi megjithëse jo të karakterit procedural, por që janë detyrim për tu plotësuar nga anëtarët e KPP-së, si deklarata e paanësisë e nënshkruar nga anëtarët e KPP-së dhe raporti informues në përfundim të konkurrimit drejtuar njësisë së burimeve njerëzore.

Në këto kushte, është detyrë e njësisë së burimeve njerëzore që në të ardhmen të plotësojë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, që hartohen në një procedurë konkurrimi dhe ti administrojë ato në dosjet përkatëse të secilës procedurë.

**a/1) Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; Kreu V, i Vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, i shfuqizuar, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM), si dhe Kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në institucionin e Avokatit të Popullit janë emëruar, nëpunës civilë në periudhë prove punonjësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 17/4, datë 1.2.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 59, datë 22.4.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve.
3. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 119, datë 9.10.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve.
4. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 113/7, datë 7.4.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i prokurimeve*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
5. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 122, datë 15.9.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve. Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj punonjëseje, rezulton se është emëruar nga lista e fituesve.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjet e personelit, konstatohet se gjatë vitit 2020, ka mbaruar periudha e provës edhe për 3 punonjës të emëruar gjatë vitit 2019, si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 152, datë 21.5.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i financës dhe prokurimeve*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 165, datë 5.6.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
3. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 292, datë 12.12.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Europian.

Rezulton se, për të gjithë nëpunësit si më sipër, ka mbaruar periudha e provës, e cila, bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Konstatohet se, nëpunësit, kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në përfundim të tij janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50% të pikëve. Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore. Periudha e provës është përfunduar me nxjerrjen e vendimit të konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësit përkatës.

Nga verifikimi i mëtejshëm, konstatohet se, në të gjitha rastet, procedurës së vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, **i mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë**, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, si një element i rëndësishëm ligjor që shoqëron vendimmarrjen e eprorit direkt.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes rezulton se, dy nëpunës, vazhdojnë të jenë në periudhë prove:

1. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 58/3, datë 1.4.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist protokolli*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore.
2. \*\*\*\*\*, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 136/3, datë 12.7.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve.

*(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës, të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në Tabelën nr.1, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).*

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke i konfirmuar nëpunës civilë punonjësit e kësaj kategorie, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, përveç mungesës së një elementi të rëndësishëm, që është është mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë.

Sipas pikës 2, neni 24, i ligjit, si dhe kreut VI, “*Periudha e provës*”, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, caktimi i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë për të udhëzuar nëpunësin në periudhë prove, është një element i domosdoshëm, për orientimin e nëpunësit të ri në kryerjen e detyrës dhe që duhet të përfshihet në aktin e emërimit. Në përfundim, procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, duhet të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, përfshirë këtu mendimin me shkrim të nëpunësit më të vjetër civil në detyrë.

Kjo mangësi, është një parregullsi e veprimtarisë së njësisë së burimeve njerëzore, por që nuk e cënon në thelb procesin e konfirmimit, si dhe marrëdhënien e punës të nëpunësve civilë të konfirmuar. Ajo vihet në dukje në këtë moment, për t’u patur parasysh në të ardhmen, që raste të tilla të mos përsëriten dhe procedura e konfirmimit apo jo të nëpunësit civil, të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, sipas kërkesave të ligjit.

➤ Lista e kandidatëve fitues të pa emëruar

Nga verifikimi i të dhënave, konstatohet se në konkurrimin e zhvilluar për pozicionin “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, i zhvilluar në vitin 2020, janë shpallur dy fitues: \*\*\*\*\*, 83 pikë (*emëruar*) dhe \*\*\*\*\*, 76 pikë, kandidatë fituese e pa emëruar, e regjistruar në listën e fituesve.

Sipas pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe pikës 18, Kreu IV, të VKM nr.243, datë 18.3.2015, **lista e kandidatëve të paemëruar ende, është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare nga shpallja e fituesve.**

Më tej, në pikën 3 dhe 3/1, të nenit 23, të ligjit, si dhe në pikën 1, Kreu V, të aktit nënligjor, përcaktohet se, *nëse gjatë periudhës 2-vjeçare, zhvillohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin grup, kandidatët fitues të listave, që nuk janë emëruar ende, rirenditen sipas rezultatit përfundimtar. Vendet e lira, të krijuara në mënyrë të përkohshme, mund të plotësohen nga kandidatët fitues të paemëruar ende, sipas rirenditjes.*

Këto përcaktime ligjore, njësia përgjegjëse e institucionit të mbikëqyrur, i ka mbajtur në vëmendje dhe gjatë kohës së vlefshmërisë së listës së fituesit, me aktin nr. 62, datë 1.4.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Për emërimin e përkohshëm të zj. Dorina Mehmetaj, në detyrën “Specialiste”, në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European*”, ka emëruar përkohësisht kandidaten fituese D. Mehmetaj, në pozicionin e krijuar të lirë për shkak të lejes së lindjes të nëpunëses që kryente këtë detyrë.

Më pas, me krijimin e vakancës në pozicionin, “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”, duke qenë se kandidatja fituese e paemëruar, \*\*\*\*\*, rezulton të jetë brenda afatit 2 vjeçar të vlefshmërisë së listës së fituesve, si dhe duke parë se plotëson të gjitha kriteret specifike të vendit të punës, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit të saj, nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin, “*Specialist i shërbimeve ndaj qytetarit*”.

Aktualisht, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes në këtë institucion, nuk ka asnjë kandidat fitues të pa emëruar të regjistruar në listën e fituesve.

### **II.3. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil.**

Bazuar në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.

Rregullat që duhet të ndjekë njësia përgjegjëse për organizimin e procedurës së konkurrimit për këto raste, janë të parashikuara në nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil, në Kreun II dhe III, të Vendimit nr.242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe në kreun IV dhe V, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se, për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2022, janë realizuar **12** procedura konkurrimi për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese si më poshtë:

- **9** procedura janë realizuar nëpërmjet ngritjes në detyrë dhe
- **3** procedura janë realizuar nëpërmjet pranimin nga jashtë shërbimit civil.

Konstatohet se shpallja e procedurave të konkurrimit, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, janë bërë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe faqen e internetit të institucionit, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 3 deri në 7, të kreut II, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar.

### **II.3/a. Procedura e lëvizjes paralele për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.**

Nga këqyrja e dokumentacionit, për periudhën objekt mbikëqyrjeje Janar 2020 – Dhjetor 2022, në institucionin e Avokatit të Popullit, rezulton që procedura e lëvizjes paralele për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, nuk është zhvilluar në asnjë rast.

Pozicionet e punës të ngelura të lira, janë plotësuar nëpërmjet procedurës ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil.

### **II.3/b. Procedura e ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.**

Për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, në periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2022, janë zhvilluar **12** procedura konkurrimi nëpërmjet ngritjes në detyrë, për pozicionet si më poshtë:

- Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve (*zhvilluar 2 procedura*);
- Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore;
- Përgjegjës në Sektorin për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European (*zhvilluar 2 procedura*);

- Ndhimëskomisioner, niveli II- b (*zhvilluar 7 procedura*);

Vemë në dukje faktin se, në *3 raste*, procedura është zhvilluar edhe me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, përcaktuar në pikën 43, të Kreut III, të aktit nënligjor, në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për pozicionin si më poshtë:

- Ndhimëskomisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre (*3 procedura të kryera përkatësisht në vitin 2020, 2021, 2022*);

Në lidhje me procedurat e zhvilluara me kandidatë nga jashtë shërbimit civil për 3 pozicionet me emërtesën Ndhimëskomisioner niveli II-b, si më sipër, konstatohet:

*Së pari*, sipas përcaktimeve në aktin ligjor e nënligjor, plotësimi i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, bëhet me vendim të titullarit të institucionit.

Në rastin konkret, nga verifikimi i mëtejshëm, rezulton se, procedura e konkurrimit për pozicionin, “*Ndhimëskomisioner, niveli II-b*”, e përfunduar në vitin 2020, është përfshirë në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil të vitit 2019 dhe procedura ka nisur që në këtë vit. Gjithashtu, në aktin nr. 303, datë 27.12.2019, të titullarit të institucionit, “*Për hapjen e procedurës së pranimi në kategorinë e mesme drejtuese edhe me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2019*”, është përcaktuar plotësimi i këtij pozicioni me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë.

Po kështu, edhe për vitet 2021-2022, konstatohet se, për çdo procedurë, ka një akt të titullarit të institucionit, që përcakton plotësimin e vendit të punës edhe me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për të cilën kemi folur edhe më sipër në material, në pjesën ku flitet për miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil.

*Së dyti*, numri i vendeve të lira të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, që do të plotësohen me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nga verifikimi rezulton se, numri i pozicioneve të punës që janë plotësuar me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, nuk e ka tejkaluar numrin sipas përcaktimeve të ligjit.

Në *9 raste*, procedura është zhvilluar me *ngritje në detyrë*, për pozicionet si më poshtë:



- Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve (*1 procedurë në vitin 2021; 1 procedurë në vitin 2022*);
- Përgjegjës Sektori Burimeve Njerëzore (*procedura e vitit 2022*);
- Përgjegjës Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European (*1 procedurë në vitin 2021; 1 procedurë në vitin 2022*);
- Ndhimëskomisioner, niveli II- b (*1 procedurë 2020; 3 procedura 2022*);

Duke patur parasysh përcaktimet ligjore që, plotësimi i vendeve të lira me këtë procedurë është i hapur për nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët në të njëjtin institucion apo institucione të tjera të shërbimit civil, konstatohet se, për pozicionet, “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve”; “Përgjegjës Sektori Burimeve Njerëzore”; “Përgjegjës Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin European” dhe 2 pozicione, “Ndhimëskomisioner niveli II-b” (*procedura të zhvilluara gjatë viteve 2020-2022*), kanë konkurruar dhe janë shpallur fitues, nëpunës të këtij institucioni. Ndërsa në dy raste për pozicionin “Ndhimëskomisioner niveli II-b”, kanë konkurruar dhe janë shpallur fitues nëpunës civilë që kryenin detyra në institucione të tjera.

Në vijim, u verifikuan procedurat e konkurrimit për ngritje në detyrë, në drejtim të përmbushjes së afateve ligjore të parashikuara në pikën 4 dhe 6, të Kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015. Në këto dispozita është përcaktuar se, shpallja e procedurës për ngritjen në detyrë, botohet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e vlerësimit dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit nuk duhet të jetë më i vogël se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes. Në lidhje me sa më sipër, grupi i punës konstatoi se këto afate janë respektuar.

Gjithashtu, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, në të gjitha rastet, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 5, të kreut III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, siç janë:

- a) pozicioni i punës që është vakant (*emërtesa e pozicionit sipas strukturës dhe organikës në fuqi*);
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit që është i përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- dh) data e daljes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së ngritjes në detyrë dhe të përmbushjes së kriterëve të veçanta të vendit të punës;
- e) fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen;
- f) mënyra e vlerësimit të kandidatëve;
- g) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë, sipas pikës 21, të Kreut III, përfshin dy faza:

- a) Verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve.

➤ Verifikimi paraprak i kandidatëve

Verifikimi paraprak, bëhet nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, e cila, në bazë të përcaktimeve të pikës 22 dhe 26, të Kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015 dhe sipas dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e kërkesat e posaçme dhe, brenda 10 ditëve kalendarike, që është përfundimi i afatit të ankimimit, bën verifikimin përfundimtar.

Për çdo procedurë të realizuar, rezulton se lista me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës është shpallur në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në faqen e internetit të institucionit.

Gjithashtu konstatohet se, në shumicën e rasteve ka patur nga 1 kandidat që ka aplikuar, ose në rastet kur ka patur më shumë se një kandidat, nuk ka patur të skualifikuar dhe për rrjedhojë nuk ka patur ankesa. Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore, nuk e ka vlerësuar të nevojshme të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, por ka vazhduar procesin sipas përcaktimeve në aktin e publikimit.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, kandidatët që kanë aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë, i plotësojnë kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të Kreut III, të aktit nënligjor, si më poshtë:

- ✓ Janë nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit nga institucionet ku ata kryenin detyrën.
- ✓ Nuk kanë masë disiplinore në fuqi, të vërtetuar me akt zyrtar nga institucioni ku kryejnë detyrën.
- ✓ Vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim, janë në nivelin “Mirë” ose “Shumë mirë”.
- ✓ Plotësojnë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, siç janë lloji dhe niveli i diplomës, eksperiencia në vite në fushën përkatëse, si dhe njohja e një gjuhe të huaj.
- ✓ Për kandidatët që konkurrojnë nga brenda institucionit, rezulton që vlerësimi i fundit nuk administrohej në dokumentacionin e paraqitur për konkurrim.

➤ Vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND).

Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë, realizohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND), i cili, sipas pikës 7, Kreu III, të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, i ndryshuar, përbëhet nga pesë anëtarë:

- a) 1 anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;
- b) 1 anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;
- c) eprorin direkt të pozicionit për të cilin zhvillohet konkurrimi;
- d) 2 ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në institucionin e mbikëqyrrur, edhe për procedurat e kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, të shpallura për periudhën Janar 2020 deri në Dhjetor 2022, janë ngritur KPND, rast pas rasti siç janë zhvilluar procedurat e konkurrimit. Në të gjitha rastet, rezulton që përfaqësuesi i burimeve njerëzore, është në cilësinë e anëtarit të KPND-së dhe jo kryesues, sikundër e parashikojnë aktet ligjore të sipërcituara.

Në bazë të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pikave nga 27 deri në 33, të Kreut III, të VKM nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 27.3.2015, të DAP, kandidatët e kualifikuar për të kaluar në fazën e dytë të konkurrimit, vlerësohen nga KPND, ku përfshihet:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë (20 pikë);
- b) Vlerësimi me shkrim (40 pikë);
- c) Intervista e strukturuar me gojë (40 pikë).

Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati nuk konsiderohet fitues nëse nuk ka marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Në lidhje me vlerësimin e kandidatëve nga KPND, nga verifikimi rezulton se është vepruar në këtë mënyrë:

Për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPND, kanë përgatitur testet përkatëse, që edhe në këtë rast, ashtu si edhe në konkurrimet e tjera të zhvilluara në këtë institucion, modelin e testit me shkrim e paraprin procesverbali për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPND, të cilët kanë nënshkruar në fund të tij dhe jo në testin e hartuar. Në të gjitha rastet mungon çelësi i përgjigjeve të cilën duhet ta administrojë secili prej anëtarëve në momentin e zhvillimit të konkurrimit.

Testet përmbajnë pyetje me alternativa dhe me shtjellim. Pyetjet me alternativa janë hartuar sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1, të ndarjes V/5, të udhëzimit të DAP, si dhe brenda fushës së njohurive dhe aftësive, kompetencave, mbi të cilat do të zhvillohet testimi, të përfshira në shpalljen për konkurrim. Anëtarët e KPND kanë korrigjuar testet dhe kanë vlerësuar kandidatët duke dhënë pikët për secilin.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se, në vlerësimin me shkrim, anëtarët e KPND, kanë zbatuar rregullat e pikës 8, të paragrafit III/6, të udhëzimit të DAP, duke pjestuar shumën totale të pikëve me pesë (*në bazë të numrit të vlerësuesve*).

Në përfundim të këtij testimi, si dhe të *vlerësimit të jetëshkrimit* (*i cili është bërë sipas modelit të vlerësimit në Aneksin nr.7, bashkëlidhur udhëzimit të DAP*), kanë rradhitur kandidaturat (*në rastet kur ka patur më shumë se një*), të cilët janë kualifikuar për fazën e intervistës me gojë.

Në lidhje me *intervistën me gojë*, KPND, ka vepruar në këtë mënyrë:

- ✓ Ka hartuar pyetjet që lidhen me njohuritë, aftësitë, eksperiencën që nevojiten për pozicionin e punës dhe që janë brenda fushës së testimit të publikuara në shpallje, të cilat janë të nevojshme për të gjithë kandidatët.
- ✓ Brenda afateve të parashikuara, KPND, ka zhvilluar intervistën me gojë me secilin nga kandidatët dhe më pas ka hartuar raportin e procedurës së zhvilluar duke bërë vlerësimin, i cili, sipas udhëzimit të DAP, është i njëjtë me atë të lëvizjes paralele, por shuma totale, në këtë rast, pjesëtohet me pesë (*numri i vlerësuesve*).
- ✓ Në të gjitha rastet, kandidatët kanë nënshkruar deklaratat e mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë.
- ✓ Rezulton që anëtarët e KPND, në të gjitha rastet, **nuk kanë firmosur** deklaratën e paanësisë, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, KPND ka hartuar raportin përfundimtar për rezultatin e konkurrimit.

Njësia e burimeve njerëzore, duke respektuar afatet që përcaktojnë aktet ligjore e nënligjore, ka shpallur fituesit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në faqen zyrtare të institucionit; njëkohësisht ka dalë edhe akti i emërimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Nga sa më sipër, si dhe sipas strukturës aktuale të institucionit, janë emëruar me procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, për pozicione të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese, nëpunësit si më poshtë, të cilët vazhdojnë të kryejnë detyrën edhe në momentin e realizimit të mbikëqyrjes:

### **Ngritje në detyrë niveli i ulët drejtues**

1. \*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve”, me aktin nr. 40/3, datë 24.2.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm.
2. \*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse e Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integritit Europian”, me aktin nr. 160, datë 21.10.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm.
3. \*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore”, me aktin nr. 170/1, datë 12.9.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.
4. \*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve”, me aktin nr. 116, datë 6.6.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.
5. \*\*\*\*\*, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse e Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Integritit Europian”, me aktin nr. 154/2, datë 15.8.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.

### **Ngritje në detyrë niveli i mesëm drejtues**

6. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 125, datë 23.10.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin, “Ndhmëskomisioner, niveli II-b”, në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar.
7. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 82/2, datë 5.5.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin, “Ndhmëskomisioner niveli II-b”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre.
8. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 128/2, datë 20.6.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin “Ndhmëskomisioner, niveli II-b”, në Seksionin e Përgjithshëm.
9. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 226/2, datë 16.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin, “Ndhmëskomisioner, niveli II-b”, në Seksionin e Përgjithshëm.

### **Pranim nga jashtë shërbimit civil, niveli i mesëm drejtues**

10. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 43, datë 18.2.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin “Ndhmëskomisioner, kategoria II-b”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre.
11. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 144/1, datë 8.10.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin “Ndhmëskomisioner, kategori page II-b”, në Seksionin për

Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre.

12. \*\*\*\*\* , me aktin nr. 122/1, datë 17.6.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm, është emëruar në pozicionin “Ndhmëskomisioner, kategori page II-b”, në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nëpërmjet procedurës lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe me pranim nga jashtë shërbimit civil, në përgjithësi, janë realizuar sipas përcaktimeve të neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Përsa i përket rolit të njësisë së burimeve njerëzore në Komitetin e Pranimit të Ngritjes në Detyrë, përfaqësuesi i saj, duhet të kryesojë këtë komitet, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, siç e kemi thënë më sipër në material dhe të kujdeset që dokumentacioni që nevojitet në një procedurë konkurrimi të jetë i plotë dhe i administruar në dosjen përkatëse.

**II.4. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit; respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komiteti të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.**

Nga këqyrja e strukturës dhe organikës në fuqi, rezulton se institucioni i mbikëqyrur ka 14 pozicione pune të kategorisë së lartë drejtuese, si më poshtë:

- Sekretar i Përgjithshëm;
- Ndhmëskomisioner, kategori page II-a.

Procedurat e konkurrimit për pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura, organizohen në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil dhe kreun III, VIII dhe IX, të Vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit

*të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.*

Gjatë periudhës objekt mbikëqyrjeje janë zhvilluar 4 procedura konkurrimi, në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, nga të cilat 3 pozicione pune janë plotësuar me procedurën e pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm drejtues (ngritje në detyrë), të parashikuar nga shkronja “a”, pika 1, Kreu VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar; ndërsa 1 pozicion pune i kësaj kategorie, është plotësuar me procedurën e hapur për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, e parashikuar në shkronjën “b”, pika 1, Kreu VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar.

- *Faza e parë e konkurrimit për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm drejtues (ngritje në detyrë)*

Procedurat e konkurrimit janë organizuar nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, e cila, në të gjitha rastet e mësipërme, ka bërë shpalljen e procedurës së konkurrimit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit, përkatësisht në datat 18.6.2020; 14.9.2020; 11.2.2022 dhe 28.2.2022.

Në shpalljet e publikuara për pozicionet:

1. *Ndihmëskomisioner*, në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar, (data 18.6.2020);
2. *Ndihmëskomisioner*, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, (14.9.2020),
3. *Ndihmëskomisioner*, në Seksionin e Përgjithshëm, (11.2.2022),

është përcaktuar se procedura është e hapur për nëpunësit civilë të konfirmuar në kategorinë e mesme drejtuese, të cilët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në këtë kategori.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezultoi se, në përmbajtjen e shpalljeve për konkurrim, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 6, të Kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se është respektuar afati kohor prej 60 ditësh që parashikon pika 4, e Kreut VIII, të aktit nënligjor.

Më tej, për secilën procedurë, njësia e burimeve njerëzore ka bërë verifikimin paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret specifike dhe në përfundim të verifikimit i ka kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, duke i shpallur në portalin, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Rezulton që për këto pozicione, kanë konkurruar 4 nëpunës që kryejnë detyra të nivelit të mesëm drejtues, konkretisht:

1. \*\*\*\*\*, Ndhmëskomisioner, kategoria II-b, pranë Avokatit të Popullit (*konkurron për pozicionin "Ndhmëskomisioner II-a"*);
2. \*\*\*\*\*, Ndhmëskomisioner, II-b, pranë Avokatit të Popullit (*konkurron për pozicionin "Ndhmëskomisioner II-a"*);
3. \*\*\*\*\*, Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Pritjes së Qytetarëve, pranë Avokatit të Popullit (*konkurron për pozicionin "Ndhmëskomisioner II-a"*).
4. \*\*\*\*\*, Drejtore e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*konkurron për pozicionin "Ndhmëskomisioner II-a"*);

Grupi i punës verifikoi kriteret e posaçme të përcaktuara në shpalljen e vendeve të lira si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët dhe nga të dhënat, rezulton se, ata i plotësojnë kërkesat e veçanta sipas shpalljeve për konkurrim, si më poshtë:

- Janë nëpunës civilë të konfirmuar, të kategorisë së mesme drejtuese;
- Nuk kanë masë disiplinore në fuqi, të vërtetuar me akt zyrtar të titullarit të institucionit;
- Vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim, janë në të gjitha rastet, në nivelin "*Shumë mirë*";
- Plotësojnë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

➤ *Faza e dytë e konkurrimit:*

Pasi është përfunduar faza e parë e konkurrimit, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (*KPP*), i cili është i ndryshëm për çdo procedure. Për realizimin e fazës së dytë të konkurrimit, *KPP* ka ndjekur hapat e përcaktuar në pikat 11-19, të kreut IV, të VKM nr.118, datë 5.3.2014, i ndryshuar.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në të katër procedurat, është ngritur me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, me përbërje të rregullt, por përfaqësuesi i burimeve njerëzore, i cili duhet të kryesojë komitetin, është në cilësinë e anëtarit, ç`ka është evidentuar në të gjitha komisionet e ngritura për procedura konkurrimi. Anëtarët e *KPP*, nuk kanë qenë në kushtet e pamundësisë ligjore për të kryer detyrën, për këtë arsye nuk ka qenë e nevojshme zëvendësimi i tyre. *KPP*-ja i ka marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.



➤ *Vlerësimi i kandidatëve*

KPP-ja vlerëson kandidatët si më poshtë:

- a) Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), vlerësimi maksimal 10 pikë (*Vlerësimi i jetëshkrimit përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve vjetore*).
- b) Testimi me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- c) Intervistë e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 50 pikë.

Për realizimin e vlerësimit të kandidatëve, komiteti i pranimit ka hartuar pyetjet e vlerësimit me shkrim, të cilat kanë qenë me alternativë dhe shtjellim, si dhe pyetjet e vlerësimit me gojë. Pyetjet janë hartuar duke patur në konsideratë fushën e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Edhe në këtë rast, mungojnë përgjigjet me shkrim të testit, të cilat anëtarët e KPP, duhet ti kenë të administruara në momentin e zhvillimit të procedurës.

Anëtarët e KPP, edhe në këtë rast **nuk kanë nënshkruar deklaratën e paanësisë**, për të deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim.

Secili nga anëtarët e KPP ka vlerësuar çdo pyetje me pikë. Intervista me gojë është zhvilluar në të njëjtën ditë që është zhvilluar edhe testimi me shkrim. Kandidatët, në të gjitha rastet, kanë nënshkruar deklaratën se nuk pranojnë që intervista të regjistrohet.

Në përfundim të vlerësimit, KPP ka përgatitur raportin përfundimtar të vlerësimit për secilin kandidat, por edhe në këtë rast, si në të gjitha procedurat e konkurrimit, **mungon vendimi që shpall kandidatin fitues**.

Më pas, njësia përgjegjëse, nëpërmjet akteve përkatëse, emrat e kandidatëve fitues i ka shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në faqen e internetit të institucionit.

Në dy procedurat për pozicionin “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre dhe “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin e Përgjithshëm, për shkak se kanë qenë kandidatë të vetëm të shpallur fitues, **nuk janë ruajtur afatet ligjore të ankimit**, të parashikuara në pikën 19, të Kreut IV, të VKM nr.118, datë 5.3.2014, i ndryshuar, por, menjëherë, procesi ka vijuar me nxjerrjen e aktit të emërimit për secilin kandidat fitues, si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin, “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, me aktin nr. 142, datë 25.11.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm. (Me aktin nr. 158, datë 22.12.20200, pezullim nga shërbimi civil për shkak të ligjit).
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin, “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin e Përgjithshëm, me aktin nr. 68/2, datë 15.4.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.

Përsa i përket konkurrimit për pozicionin e punës “*Ndihmëskomisioner*”, në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, publikuar në datën 18.6.2020, **janë kualifikuar dy kandidatura**, sikundër jemi shprehur edhe më sipër në material. Por, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e konkurrimit, në përmbajtjen e akteve që prodhohen në përmbushjen e procesit (testimi me shkrim, deklarta për mosregjistrimin e intervistës me gojë, procesverbalet e hartuara nga KPP-ja për vlerësimin e konkurrentit në testimin me shkrim, intervistën e strukturuar me gojë, vlerësimi i jetëshkrimit dhe raporti përfundimtar) nuk përmendet ky fakt.

Pjesëmarrja e konkurrentit të dytë në konkurrim konstatohet nga email-i që njësia e burimeve njerëzore, i ka dërguar konkurrentes \*\*\*\*\*, nëpërmjet të cilit i bën me dije se në përfundim të konkurrimit të zhvilluar në datën 17.8.2020, KPP-ja, e ka vlerësuar me 67 pikë, tregon për pjesëmarrjen në konkurrim të të dy kandidatuarave të kualifikuara. Më tej, njoftimi për shpalljen e fituesit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, i cili mban datën 25.8.2020, tregon se janë ruajtur afatet ligjore të ankimit, të parashikuara në pikën 19, të Kreut IV, të VKM nr.118, datë 5.3.2014, i ndryshuar. Më pas njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit për kandidaten fituese si më poshtë:

\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin, “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, me aktin nr. 102, datë 25.8.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm.

Nga sa më sipër, vlerësojmë se Komiteti i Përhershëm i Pranimit si dhe njësia e burimeve njerëzore, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në këtë komitet, duhet të kujdeset që në fillim të testimit, të mbajë procesverbalin e prezencës në konkurrim të kandidatëve që janë kualifikuar për të vazhduar fazat e tjera të konkurrimit. Gjithashtu, në dosjen e konkurrimit duhet të administrohen të gjitha aktet e prodhuara nga KPP-ja, për të gjithë pjesëmarrësit në testim.

Përsa i përket konkurrimit për pozicionin e punës “*Ndihmëskomisioner, niveli II-a*”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, konstatohet se ky pozicion, është plotësuar me procedurën e

pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, nëpërmjet konkurrimit të hapur edhe për kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, të parashikuar nga shkronja “b”, pika 1, Kreu VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar.

Mbështetur në sa më sipër, Avokati i Popullit ka nxjerrë aktin nr. 35, datë 24.02.2022 “*Për hapjen e procedurës së pranimin në kategorinë e lartë drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2022*”, për zhvillimin e procedurës me kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

➤ *Faza e parë e konkurrimit*

Kjo procedurë, është shpallur në datën 28.2.2022, në portalin *Shërbimi Kombëtar i Punësimit* dhe në faqen zyrtare të institucionit, ashtu si e kërkon ligji, në zbatim të parimit të transparencës së procesit dhe barazisë së kandidatëve.

Në shpalljen e vendit të lirë, është përcaktuar se kjo procedurë është e hapur për nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, si dhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori.

Nga verifikimi i mëtejshëm rezulton se, në përmbajtjen e shpalljes për konkurrim, janë përfshirë të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 6, të Kreut VIII, të VKM nr. 118, datë 5.3.2014, i ndryshuar. Gjithashtu konstatohet se, është respektuar afati kohor prej 60 ditësh që parashikon pika 4, e Kreut VIII, të aktit nënligjor, pasi konkurrimi është shpallur në 28.2.2022, data e dorëzimit të dokumenteve është caktuar 28.3.2022, ndërsa konkurrimi është zhvilluar në datën 27.4.2022.

Për këtë procedurë konkurrimi kanë dorëzuar dokumentet **2** kandidatë.

Njësia e burimeve njerëzore ka bërë verifikimin paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret specifike për pozicionin, që janë:

- ✓ *lloji dhe niveli i diplomës: Master shkencor në shkenca juridike dhe diploma “Bachelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë;*
- ✓ *të zotërojë gjuhën angleze ose një një gjuhë të BE-së (të vërtetuar me certifikatë);*
- ✓ *të ketë të paktën 5 vjetpërvojë në Administratën Publike si jurist në pozicione të nivelit të mesëm (II-b), ose pozicione të barazvlefshme apomë të larta se ky nivel,*

dhe në përfundim të verifikimit paraprak ka kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, 1 kandidat (\*\*\*\*\*), duke e shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në faqen zyrtare të institucionit, në datën 7.4.2022.

Kandidati tjetër që ka aplikuar dhe nuk është kualifikuar, është njoftuar individualisht nëpërmjet email-it, se nuk plotëson kriteret specifike për këtë pozicion pune, duke e njoftuar edhe për të drejtën e ankimimit për këtë vendim.

Më tej, njësia e burimeve njerëzore, ka bërë publikimin e verifikimit përfundimtar në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe në faqen zyrtare të institucionit, në datën 19.4.2022, duke njoftuar edhe për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurrimi.

➤ *Faza e dytë e konkurrimit*

Pasi është përfunduar faza e parë e konkurrimit, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit për vlerësimin e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, për pozicionin “*Ndihmëskomisioner, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre*”.

Avokati i Popullit me aktin nr. 35, datë 24.02.2022, “*Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e lartë drejtuese edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, për vitin 2022*”, ka përcaktuar që procedura do të zhvillohet me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë. Në vijim, anëtarët e KPP-së i kanë marrë vendimet në praninë e të gjithë anëtarëve.

➤ *Vlerësimi i kandidatëve:*

KPP-ja vlerëson kandidatët si më poshtë:

- d) Vlerësimi i jetëshkrimit (CV), vlerësimi maksimal 10 pikë (*Vlerësimi i jetëshkrimit përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve, të lidhura me fushën si dhe vlerësimin e arritjeve vjetore*).
- e) Testimi me shkrim, vlerësimi maksimal 40 pikë;
- f) Intervistë e strukturuar me gojë, vlerësimi maksimal 50 pikë.

Për realizimin e vlerësimit të kandidatëve, Komisioni i Pranimit ka hartuar pyetjet e vlerësimit me shkrim, të cilat kanë qenë me shtjellim dhe alternative. Pyetjet janë hartuar duke patur në konsideratë fushën e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Intervista e strukturuar me gojë, është zhvilluar në të njëjtën ditë me testimin me shkrim. Kandidati ka nënshkruar deklaratën e mospranimit që intervista të regjistrohet.

Në përfundim të vlerësimit, sipas raportit përfundimtar datë **27.4.2022**, të KPP, është shpallur kandidati fituese \*\*\*\*\*, i cili ka grumbulluar 85 pikë dhe këto materiale i janë dorëzuar njësisë së burimeve njerëzore. Sipas akteve të vëna në dispozicion të grupit të punës, shpallja e fituesit, është bërë në datën **5.5.2022**.

Më pas, njësia e burimeve njerëzore ka nxjerrë aktin e emërimit.

- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre, me aktin nr. 87/3, datë 1.6.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm.

**Konkluzion:** Procedurat e konkurrimit për pranimin në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura, për pozicionet “*Ndihmëskomisioner, kategori page II-a*”, në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre; Seksionin e Përgjithshëm dhe Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës, janë organizuar në bazë të rregullave të parashikuara në nenin 32, të ligjit për nëpunësin civil dhe kreun III, VIII dhe IX, të VKM nr. 118, dt. 5.3.2014 “*Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar.

Përsa i përket rolit të njësisë së burimeve njerëzore në Komitetin e Pranimit të Ngritjes në Detyrë, përfaqësuesi i tij, duhet të kryesojë këtë komitet, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, siç e kemi thënë më sipër në material.

Në lidhje me mangësitë e evidentuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Ndihmëskomisioner në Seksionin Mekanizmi për Parandalimin e Torturës, Trajtimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës*”, tregojnë për parregullsi në dokumentacionin që pasqyron punën e Komitetit të Përhershëm të Pranimit. Edhe në këtë rast, vlerësohet se, është detyrë e njësisë së burimeve njerëzore që të tregojë kujdes në hartimin dhe administrimin e gjithë dokumentacionit që duhet të hartohet në një procedurë konkurrimi.

### **Konstatim:**

Nga analiza e kryer në lidhje me procedurat e konkurrimit të zhvilluara gjatë periudhës objekt mbikëqyrjeje Janar 2020 – Dhjetor 2022, konstatohet si më poshtë:

- ✓ Krijimi i vendeve të lira gjatë vitit si rrjedhojë e dorëheqjes, pezullimit (*për një afat më të gjatë se 3 muaj*), apo lirimit nga shërbimi civil, sipas shkaqeve të parashikuara në ligj, nuk janë reflektuar në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, të miratuar në fillim të vitit.

- ✓ Organizimi i procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, janë realizuar si procedura individuale, duke mos e vlerësuar më parë mundësinë e rekrutimit në grup pozicionesh. Duhet që në të ardhmen, aty ku paraqitet mundësia, procedurat konkurruese të realizohen sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe me kritere të njëjta, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë.
- ✓ Në përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, përfaqësuesi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në të gjitha rastet është në cilësinë e anëtarit dhe jo kryesues i tij ashtu si janë përcaktimet ligjore.

Gjithashtu, rezulton që Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur si më sipër, nuk ka funksionuar për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit, por ndryshe nga sa parashikon legjislacioni, ai është ngritur rast pas rasti për secilën procedurë të realizuar brenda të njëjtit vit.

- ✓ Në të gjitha procedurat e konkurrimit të zhvilluara gjatë viteve 2020-2022, janë evidentuar mangësi megjithëse jo të karakterit procedural, por që janë detyrim për tu plotësuar nga anëtarët e KPP-së, si deklarata e paanësisë e nënshkruar nga anëtarët e KPP-së dhe raporti informues në përfundim të konkurrimit drejtuar njësisë së burimeve njerëzore.

Këto parregullsi të shtjelluara edhe më sipër në material në pikat përkatëse, në rast përsëritjeje, mund të përbëjnë shkak për paligjshmëri në zbatimin e procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë.

Për sa më sipër, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, të kryejnë analizën e plotë dhe të marrin masat për mospërsëritjen e këtyre parregullsive.

**V. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Kpmisionit të Disiplinës.**

Procedura e dhënies së masës disiplinore është përcaktuar në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në Vendimin nr.115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes në institucionin e Avokatit të Popullit, u konstatua se ka patur 1 (një) rast të fillimit të procedimit disiplinor dhe bëhet fjalë për nëpunësin civil \*\*\*\*\*\*, “Ndhmëskomisioner, në Seksionin e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre”.

Shkaku i dhënies së masës disiplinore është mosadministrimi me korrektësi i dokumentacionit original të korrespondencës për çështje të caktuara që ruhen dhe administrohen nga vetë Ndhmëskomisioneri, deri në mbylljen e praktikës dhe arkivimin e tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë rast, Komisioneri konstaton se, shkelja e pretenduar është klasifikuar në “shkelje të lehta”, parashikuar në shkronjën “c”, të nenit 57, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Rezulton që, Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e eprorit direkt, nëpërmjet aktit nr. 389 prot., datë 3.6.2021 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore”, ka njoftuar nëpunësin për fillimin e ecurisë disiplinore; shkakun e nisjes së kësaj ecurie; të drejtën e tij për të paraqitur me shkrim sqarimet rreth shkeljes së pretenduar; të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Më tej, në përfundim të shqyrtimit të provave për shkeljen disiplinore të pretenduar dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të pretendimeve dhe shpjegimeve të paraqitura në formë shkresore nga nëpunësi i proceduar, eprori direkt, në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në pikën 1, shkronja “c”, të nenit 57, si dhe në shkronjën “a” të nenit 58, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpërmjet vendimit nr.389/3 prot., datë 11.6.2021 “Vendim për marrjen e masës disiplinore”, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin \*\*\*\*\*.

Në përfundim, vërehet se nuk ka asnjë dokument të administruar në dosje dhe të vënë në dispozicion të grupit të punës, që të vërtetojë që nëpunësi ka ushtruar të drejtën e ankimit për masën e dhënë.

Konstatohet që masa disiplinore e marrë nga nëpunësi, është ende e pashuar, pasi nuk ka kaluar afati i shuarjes për shkak të ligjit, i parashikuar nga neni 61, pika 1, shkronja “a” e ligjit ku përcaktohet se:

*Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit pas kalimit të këtyre afateve: a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a”, të nenit 58 të këtij ligji.*

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe ajo materiale,

janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thënieve të tij dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

## **VI. Të tjera**

Gjatë kohës së verifikimit në subjekt, grupi i punës u njoh me një informacion të ardhur pranë Komisionerit, nga punonjësja Arta Lleshi, e regjistruar me nr. 97 prot., datë 30.1.2023, në përmbajtje të së cilës nëpunësja në fjalë ngre pretendimin për pengesë nga ana e institucionit për rikthimin në detyrë pas përfundimit të periudhës së pezullimit.

Grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri, kërkoi nga njësia përgjegjëse dhe administroi dokumentacionin plotësues, nëpërmjet procesverbalit administrativ të datës 2.2.2023, duke kërkuar që njësia përgjegjëse të mos vijonte më tej me procedurat e rekrutimit, deri sa të shprehej Komisioneri për këtë çështje, me qëllim që të parandalohet zbatimi i gabuar i ligjit.

Komisioneri, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, në përfundim të hetimit administrativ, është shprehur me vendimin nr. 14, datë 13.2.2023, "*Mbi paralajmërimin e institucionit të Avokatit të Popullit për të rregulluar ligjshmërinë në drejtim të aplikimit të institutit të pezullimit nga shërbimi civil*". Ky vendim është ekzekutuar nga institucioni dhe procesi është përmbyllur me vendimin nr. 26, datë 21.3.2023, të Komisionerit.

\*  
\*     \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Avokati i Popullit, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e organizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe zhvillimi i procedurave disiplinore, për periudhën janar 2020 - dhjetor 2022.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në institucionin Avokati i Popullit, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:



**Aneksi 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Avokati i Popullit”.

**Aneksi 2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Avokati i Popullit”.

## **K O M I S I O N E R I**

**Pranvera STRAKOSHA**